

VENDIM
Nr. 440, datë 31.7.2025

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS SË MESME ‘RAMIZ ARANITASI’, ÇOROVODË, SI DHE RUAJTJES SË PERIMETRIT TË SIGURISË NË SHKOLLA”, BASHKIA SKRAPAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i shkollës së mesme ‘Ramiz Aranitasi’, Çorovodë, si dhe ruajtjes së perimetrit të sigurisë në shkolla”, Bashkia Skrapar.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Skrapar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 105 974 (një milion e njëqind e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 105 974 (një milion e njëqind e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh, përballohet nga Bashkia Skrapar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Skrapar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Skrapar.

8. Bashkia Skrapar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Skrapar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Skrapar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së

projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Skrapar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Skrapar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Skrapar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Skrapar dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS ‘RAMIZ ARANTASI’ ÇOROVODË, SI DHE RUAJTJES SË PERIMETRIT TË SIGURISË NË SHKOLLA”, BASHKIA SKRAPAR

Nr. rendor	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)								VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM							SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj)	
												TRUALL			NDËRTESE			Vlera totale (leke)		
	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	Fshati ose Qyteti	Zona kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (leke/m²)	Vlera (leke)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (leke/m²)			Vlera (leke)
1	FLORA	HALIL	JAZEXHIU	Çorovodë	1420	10/65	ndërtesë	34		34	10	239	0		0	34	19,521	663,714	663,714	Shteti është pronar i truallit 10/131 (V.10 F.238) mbi të cilin është ndërtesa 10/65
2	DAJLAN	BRAHMAN	SEITI	Çorovodë	1420	10/66	ndërtesë	20	20	20	10	241	20	1,015	20,300	20	21,098	421,960	442,260	Nr.dok.7060 dhe regjistrimit 07.03.2018 Vënie sekuestro konservative nr.202/5 prot. Datë 23.01.2018 nga përmbaruesi "Kozeta Caka".
Vlera totale																			1,105,974	